



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
GJYKATA KUSHTETUESE
KOLEGJI I POSAÇËM I APELIMIT

Nr. 6-18/2019 regjistër (JR)
Datë 15.02.2022

Nr. 4 i vendimit
Datë 15.02.2024

VENDIM
NË EMËR TË REPUBLIKËS

Trupi gjykses i Kolegjit të Posaçëm të Apelimit, i përbërë nga gjyqtarët:

Ina Rama	Kryesuese
Mimoza Tasi	Relatore
Albana Shtylla	Anëtare
Rezarta Schuetz	Anëtare
Sokol Çomo	Anëtar

- mori në shqyrtim në seancë gjyqësore në dhomë këshillimi, në datat 01.02.2024, 06.02.2024 dhe 15.02.2024, në ambientet e Kolegjit të Posaçëm të Apelimit, në prani të Vëzhguesit Ndërkombëtar, z. Ferdinando Buatier de Mongeot, me sekretare gjyqësore Elba Arapi, çështjen që i përket:

KËRKUESE: Ana Gollosi, e bija e N., lindur më {***}, në {***}, banuese në {***}.

OBJEKTI: Rishikimi i vendimit të formës së prerë nr. 13, datë 08.07.2020, të Kolegjit të Posaçëm të Apelimit, i cili ka lënë në fuqi vendimin nr. 106, datë 13.02.2019, të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit.

BAZA LIGJORE: Nenet 3, 4, pika 1, 5, 6, 7, 15, 42 dhe 116, pika 1, 122 dhe 124, të Kushtetutës; Neni 6§1 i Konventës Evropiane të të Drejtave dhe Lirive Themelore të Njeriut; Nenet 494-498/a të Kodit të Procedurës Civile.

Trupi gjykues i Kolegjit të Posaçëm të Apelimit,

pasi shqyrtoi çështjen në seancë gjyqësore në dhomë këshillimi, analizoi pretendimet e kërkuases në kërkesat e paraqitura prej saj dhe parashtrimet me shkrim, e cila përfundimisht kërkoi rishikimin e vendimit nr. 13, datë 08.07.2020, të Kolegjit të Posaçëm të Apelimit, dëgjoi gjyqtaren relatores të çështjes Mimoza Tasi, si dhe pasi e bisedoi atë,

VËREN:

I. Rrethanat e çështjes

1. Kërkuesja Ana Golloshi (në vijim “kërkuesja”), me hyrjen në fuqi të ligjit nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë” (në vijim “ligji nr. 84/2016”), i është nënshtruar procesit të rivlerësimit kalimtar *ex officio*, si ndihmëse ligjore në Gjykatën Administrative të Apelit Tiranë.
2. Në përfundim të procesit të rivlerësimit, Komisioni i Pavarur i Kualifikimit, me vendimin nr. 106, datë 13.02.2019, ka vendosur: “*Shkarkimin nga detyra të subjektit të rivlerësimit, znj. Ana Golloshi, me detyrë ndihmëse ligjore pranë Gjykatës Administrative të Apelit Tiranë*”.
3. Kolegji i Posaçëm i Apelimit (në vijim “Kolegji”), pas ankimit të kërkuases, me vendimin nr. 13, datë 08.07.2020, ka vendosur: “*Lënien në fuqi të vendimit nr. 106, datë 13.02.2019, të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, që i përket subjektit të rivlerësimit, znj. Ana Golloshi*”.
4. Kërkuesja ka paraqitur në Kolegji dy kërkesa për rishikimin e vendimit nr. 13, datë 08.07.2020, të Kolegjit të Posaçëm të Apelimit. Kërkesa e parë është regjistruar në Kolegji me nr. 6-18/2019 (JR), datë regjistrimi 15.02.2022, ndërsa kërkesa e dytë është regjistruar në Kolegji me nr. {***} prot., datë 22.01.2024.
5. Trupi gjykues i Kolegjit, në zbatim të nenit 448 të Kodit të Procedurës Civile, me vendimin e ndërmjetëm të datës 01.02.2024, ka vendosur bashkimin në një proces të vetëm të dy kërkesave të paraqitura nga znj. Ana Golloshi, me nr. 6-18/2019 (JR), datë 15.02.2022 dhe nr. {***} prot., datë 22.01.2024, pasi konstatoi se ato kanë të njëjtin objekt: “Rishikimin e vendimit nr. 13, datë 08.07.2020, të Kolegjit të Posaçëm të Apelimit”. Ky vendim iu njoftua kërkuases së bashku me datën dhe orën e zhvillimit të seancës së ardhshme.

II. Pretendimet e kërkuases

6. Kërkuesja Ana Golloshi, në kërkesën e parë nr. 6-18/2019 (JR), datë regjistrimi 15.02.2022, për rishikimin e vendimit nr. 13, datë 08.07.2020, të Kolegjit, parashtron në mënyrë të përmbledhur se:
 - 6.1. Parregullsitë në emërimin e z. L.D., si gjyqtar i Kolegjit të Posaçëm të Apelimit, janë të një rëndësie të tillë që kanë cenuar thelbin e së drejtës për t’u gjykuar para një gjykate “të krijuar në përputhje me ligjin”. Këto parregullsi kanë kompromentuar në tërësi vendimin përfundimtar të Kolegjit të Posaçëm të Apelimit, pasi rasti i kërkuases është specifik, duke

qenë se gjyqtari L.D. ka qenë relatori i çështjes. Pjesëmarrja e ish-gjyqtarit L.D. në trupin gjykues ka cenuar procesin e rregullt, pasi ai asnjëherë nuk ka plotësuar kushtet ligjore për të ushtruar detyrën e gjyqtarit. Vepra penale e kryer prej këtij anëtari të trupit gjykues ka përcaktuar emërimin e tij si gjyqtar, si dhe ka ndikuar në dhënien e vendimit të trupit gjykues në dëm të interesave themelore kushtetuese të kërkueses.

6.2. Sikundër rezulton në paragrafin 29 të vendimit nr. 13, datë 08.07.2020, të Kolegjit, në dhomë këshillimi është vendosur moskalimi i çështjes në seancë dëgjimore dhe shqyrtimi i çështjes në dhomë këshillimi, duke sjellë një tjetër shkelje, atë të mosdëgjimit dhe mosgjykimit nga një gjykatë e caktuar sipas ligjit.

6.3. Kërkesa për rishikimin e vendimit nr. 13, datë 08.07.2020, të Kolegjit, bazohet në nenin 494, shkronja “c” e Kodit të Procedurës Civile, në të cilën parashikohet se: *“Palët ose përfaqësuesit e tyre apo ndonjë anëtar i trupit gjykues që ka marrë pjesë në gjykimin e çështjes, kanë kryer vepra të dënueshme penalisht, të cilat kanë ndikuar në dhënien e vendimit”*. Nga analiza dhe përmbajtja e shkronjës “c”, të nenit 494 të Kodit të Procedurës Civile, kërkesa për rishikim të një vendimi të formës së prerë bëhet e pranueshme kur plotësohen në mënyrë kumulative kushtet:

- a) *Palët ose përfaqësuesit e tyre apo ndonjë anëtar i trupit gjykues që ka marrë pjesë në gjykimin e çështjes kanë kryer vepra të dënueshme penalisht (neni 494/c i Kodit të Procedurës Civile);*
- b) *Rrethanat e faktit të parashikuara në shkronjën “c” të nenit 494 të jenë vërtetuar me vendim penal të formës së prerë (neni 495 i Kodit të Procedurës Civile);*
- c) *Vepra penale e kryer nga këto subjekte ka ndikuar në dhënien e vendimit, i cili kërkohet të rishikohet.*

6.4. Në rastin e saj, kërkuësja pretendon se është e provuar se:

- (i) në trupin gjykues që ka dhënë vendimin nr. 13, datë 08.07.2020, të Kolegjit, ish-gjyqtari L.D. ka qenë anëtar dhe relator i çështjes;
- (ii) me vendim gjyqësor të formës së prerë, ish-gjyqtari ka kryer vepra të dënueshme penalisht;
- (iii) veprat penale të kryera prej këtij anëtari të trupit gjykues kanë ndikuar thelbësisht, drejtpërdrejt në dhënien e vendimit nr. 13, datë 08.07.2020, të Kolegjit, objekt kërkesë për rishikim.

6.5. Sipas kërkueses, ndërsa dy kushtet e para provohen me vendimin nr. 13, datë 08.07.2020, të Kolegjit dhe vendimin nr. {***}, datë 26.10.2021, të Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë, lidhur me kushtin e tretë, fakti që ish-gjyqtari L.D. ka qenë relator i çështjes ka qenë vendimtar në dhënien e vendimit që kërkohet të rishikohet. Vendimi nr. 13, datë 08.07.2020, i Kolegjit, është bazuar në votën e ish-gjyqtarit L.D., i cili nuk plotësonte kushtet ligjore për të ushtruar detyrën e gjyqtarit, dhe në cilësinë e relatorit ka shtrembëruar faktet dhe provat dhe duke mos i relatuar drejt ato, në mungesë të analizës për shumë fakte dhe prova të paraqitura lidhur me procesin e rivlerësimit të kërkueses.

7. Bashkëlidhur kësaj kërkesë, kërkuësja ka paraqitur aktet: (i) vendim nr. 13, datë 08.07.2020, i Kolegjit të Posaçëm të Apelimit; (ii) shkresë nr. {***} prot., datë 07.09.2021, e Gjykatës së

Posaçme të Apelit për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar; (iii) vendim nr. {***}, datë 26.10.2021, i Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë; (iv) shkresë nr. {***} prot., datë 31.01.2022, e Kolegjit të Posaçëm të Apelimit; (v) vendim nr. 1, datë 09.12.2021, i Komisionit Disiplinor të Kolegjit të Posaçëm të Apelimit, printuar nga *linku*: https://kpa.al/wp-content/uploads/2021/12/Vendim-JD-5_2021_Luan_Daci_anonimizuar.pdf.

8. Në kërkesën e dytë nr. {***} prot., datë 22.01.2024, për rishikimin e vendimit nr. 13, datë 08.07.2020, të Kolegjit, kërkesja parashtron, ashtu si dhe në kërkesën e parë, të njëjtat shkaqe për rishikimin e vendimit nr. 13, datë 08.07.2020, të Kolegjit. Në dallim nga kërkesa e parë e datës 15.02.2022, kërkesën e dytë kërkesja e ka bazuar jo më në vendimin nr. {***}, datë 26.10.2021, të Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë, i shfuqizuar nga Gjykata Kushtetuese me vendimin nr. 21, datë 26.09.2022, por në vendimin nr. {***}, datë 21.03.2023, të Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë, një kopje të të cilit kërkesja e ka paraqitur bashkëlidhur kësaj kërkesë.

III. Vlerësimi i Kolegjit të Posaçëm të Apelimit

A. Aspekte procedurale

a) Mbi juridiksionin e Kolegjit

9. Në përputhje me nenin 179/b, pika 5 e Kushtetutës dhe nenin F, pikat 1 dhe 2 të Aneksit të Kushtetutës, Kolegji ka juridiksion (*ratione materiae*) ndaj ankimeve kundër vendimeve të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, lidhur me rivlerësimin kalimtar të subjekteve të rivlerësimit, të parashikuar nga neni 179/b, pikat 3 dhe 4 të Kushtetutës, përveç rasteve të vendimeve të dhëna, sipas nenit E, pika 2 e Aneksit të Kushtetutës. Gjithashtu, në zbatim të leximit harmonik e integral të dispozitave të nenit 4, pika 6 e ligjit nr. 84/2016 dhe nenit 1, pika 2 e ligjit nr. 49/2012 “Për organizimin dhe funksionimin e gjykatave administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative”, Kolegji zbaton edhe dispozitat procedurale administrative e ato civile, kur është rasti. Në kuadër të këtyre parashikimeve, duke mbajtur në konsideratë dispozitat e Kodit të Procedurës Civile për gjykatën që shqyrton kërkesat për rishikim, e konkretisht nenin 497, pika 1 të këtij Kodi, i cili parashikon se: *1. Kërkesa për rishikim paraqitet para gjykatës së shkallës së parë që ka dhënë vendimin, por në rast se vendimi është ankimuar në gjykatat më të larta, kompetente është gjykata më e lartë që ka shqyrtuar çështjen në themel [...], kërkesat e znj. Ana Gollosi, për rishikimin e vendimit të Kolegjit të Posaçëm të Apelimit, u morën në shqyrtim nga Kolegji si gjykata e vetme e procesit të rivlerësimit kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë.*

b) Mbi legjitimitimin e kërkeses

10. Kërkesja legjitimohet *ratione personae*, në kuptim të nenit 179/b, pika 5 e Kushtetutës, neneve C, pika 2 dhe F, pika 2 të Aneksit të Kushtetutës dhe nenit 497, pika 1 e Kodit të Procedurës Civile, pasi është palë dhe ka interes të drejtpërdrejtë në çështjen e parashtruar në Kolegji.

c) *Mbi formën dhe mënyrën e shqyrtimit të kërkesave*

11. Në përputhje me nenin 498, pika 1 e Kodit të Procedurës Civile, si dhe jurisprudencën e Gjykatës Kushtetuese¹, verifikimi i legjitimitetit të kërkuarit, bazueshmëria në ligj dhe në prova e kërkesës për rishikimin e vendimit, si dhe prania e kriterëve ligjorë për shqyrtimin e saj, kryhet në seancë gjyqësore në dhomë këshillimi.

B. Vlerësimi i trupit gjykues lidhur me shkaqet e kërkesave për rishikim

- *Lidhur me pretendimin se parregullsitë në emërimin e z. L.D., si gjyqtar i Kolegjit të Posaçëm të Apelit, kanë cenuar procesin e rregullt*

12. Kërkuarja pretendon se parregullsitë në emërimin e z. L.D., si gjyqtar i Kolegjit të Posaçëm të Apelit, janë të një rëndësie të tillë që kanë cenuar procesin e rregullt, parimin e “pavarësisë dhe paanshmërisë” dhe thelbin e së drejtës për t’u gjykuar para “një gjykate të krijuar në përputhje me ligjin”.
13. Në shqyrtim të pretendimeve për cenim të “gjykatës së krijuar me ligj”, për shkak të parregullsive në emërimin e z. L.D., trupi gjykues sjell në vëmendje se Gjykata Evropiane e të Drejtave të Njeriut (në vijim “GjEDNj”), në çështjen *Besnik Cani kundër Shqipërisë* ka mbajtur qëndrimin se: “144. [...] konstatimi i një shkeljeje në të drejtën për një gjykatë të krijuar me ligj në çështjen konkrete, në vetvete, mund të mos merret si shkak për të ushtruar një detyrim sipas Konventës ndaj Shtetit përgjegjës për të rihapur të gjitha çështjet e ngjashme të cilat janë bërë res judicata sipas ligjit vendës²”. Sipas këtij qëndrimi të GjEDNj-së, nuk mund të shqyrtohet *a priori* çdo kërkesë për rishikimin e vendimeve të dhëna nga trupat gjykuese të Kolegjit ku ka qenë anëtar ish-gjyqtari L.D., vetëm për shkak të parregullsive në emërimin e tij, dhe *u takon autoriteteve kombëtare që në secilën çështje “të përcaktojnë nëse ka një nevojë të domosdoshme – të një karakteri të rëndësishëm dhe detyrues – që justifikon shmangien” nga parimet e sigurisë ligjore dhe të besimit në publik në gjyqësor “në rrethanat e veçanta të një çështje”*.³
14. Trupi gjykues vëren se kërkuarja nuk ka paraqitur asnjë kërkesë për të kundërshtuar pjesëmarrjen e z. L.D. në trupin gjykues gjatë shqyrtimit të ankimit të saj në Kolegj. Gjatë kohës që ankimi i saj ishte depozituar në Kolegj, si dhe kërkuarja kishte marrë dënimin, në datën 11.04.2019, për përbërjen e trupit gjykues, në Prokurorinë e Posaçme Kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar, në datën 07.02.2020, është regjistruar procedimi penal për veprën penale “Falsifikimi i dokumenteve”, parashikuar nga neni 186, paragrafi i parë i Kodit Penal, në ngarkim të z. L.D.. Ndërkohë, Gjykata Kushtetuese, me vendimin nr. 62, datë 29.04.2020, është

¹ Shih vendimet nr. 8/2002, nr. 6/2003, nr. 17/2005, nr. 8/2006, nr. 5/2007 dhe nr. 4/2009, të Gjykatës Kushtetuese.

² Po aty, shih referencën Guðmundur Andri Ástráðsson, §314.

³ Referuar paragrafit 88 të vendimit: “Duke pasur parasysh sa më sipër, Gjykata theksoi se parimi i shtetit të së drejtës përfshin një numër parimesh të tjera po aq të rëndësishme dhe mundësisht kundërbalancuese. Këto parime përfshijnë veçanërisht sigurinë ligjore dhe respektin për forcën e res judicata, si edhe parimin e palëvizshmërisë së gjyqtarëve gjatë mandatit të tyre; shmangia nga këto parime mund të justifikohet vetëm në rrethanat të jashtëzakonshme dhe të mirëpërcaktuara. U takon autoriteteve kombëtare që në secilën çështje “të përcaktojnë nëse ka një nevojë të domosdoshme – të një karakteri të rëndësishëm dhe detyrues – që justifikon shmangien” nga parimet e sigurisë ligjore dhe të besimit në publik në gjyqësor “në rrethanat e veçanta të një çështje”.

shprehur lidhur me kërkesën e ish-prokurorit B.C., për verifikimin e zgjedhjes së z. L.D. si anëtar i Kolegjit të Posaçëm të Apelimit. Nisur nga këto rrethana, kërkesja nuk mund të mos ketë pasur dijeni për problematikën në emërimin e z. L.D. si anëtar i Kolegjit, por ajo ka zgjedhur që të mos paraqesë asnjë kërkesë lidhur me ligjshmërinë e pjesëmarrjes së z. D. si anëtar i trupit gjykues, dhe për të kërkuar përjashtimin e tij. Në rastin e kërkesës, rrethanat që do të vinin në dyshim pjesëmarrjen e z. L.D., si anëtar i trupit gjykues dhe si relator i çështjes, kanë qenë të njohura dhe janë bërë publike para dhënies së vendimit për çështjen e saj nga Kolegji, në datën 08.07.2020. Lidhur me situatën e ngjashme, GjEDNj-ja në vendimin *Sevdari kundër Shqipërisë* është shprehur se *një palë në një proces gjyqësor e cila ka dyshime për ligjshmërinë e emërimit të një gjyqtari që merr pjesë në seancën e çështjes së tij/saj, çka mund të ndikojë negativisht në cilësinë e parimit “të themeluar nga ligji” të asaj gjykate, përgjithësisht pritet t’i drejtojë ato pyetje përpara gjykatës dhe/ose të ndjekë çdo mjet tjetër efektiv të parashikuar nga ligji vendës teksa procesi është ende në pritje. Faktet referuar nga kërkesja në fjalë në lidhje me përshtatshmërinë e L.D. për të shërbyer si gjyqtar i KPA-së, dhe veçanërisht shkarkimi i tij i mëparshëm nga detyra në gjyqësor, ishin publike⁴. Edhe në vendimin *Xhoxhaj kundër Shqipërisë*, GjEDNj-ja, lidhur me pritshmërinë për të kundërshtuar mospërputhjen e pretenduar me kriteret ligjore të pranueshmërisë të anëtarëve të caktuar të KPA-së, ka vënë në dukje se kërkesja nuk pretendoi se kishte hasur ndonjë vështirësi në marrjen e informacionit të besueshëm – dhe zyrtar – mbi përzgjedhjen e këtyre anëtarëve sipas kriterëve ligjore, përpara se akuza të tilla të dilnin në dritë, dhe në çdo rast, pas publikimit të çështjes *Sevdari kundër Shqipërisë* (nr. 40662/19) më datë 22 nëntor 2019, në të cilën palët u pyetën në mënyrë specifike në lidhje me rezultatin e proceseve të brendshme kundër anëtarëve të caktuar të Kolegjit mbi pretendimin për mospërmbushje të kriterëve ligjore të pranueshmërisë⁵.*

15. Trupi gjykues vëren se kërkesja i mbështet kërkesat e saj për rishikim në garancitë për një gjykatë të krijuar me ligj, parashikuar nga neni 6 i KEDNj-së, ndonëse ajo shprehimisht i referohet nenit 494, shkronja “c” të Kodit të Procedurës Civile. Në kushtet kur aspekti që rezulton nga detyrimet që rrjedhin nga neni 6 i KEDNj-së është arsyetuar më sipër në këtë vendim, trupi gjykues i Kolegjit në vijim analizoi aspektet e tjera të kërkesave, sipas shkronjës “c”, të nenit 494 të Kodit të Procedurës Civile.

- Lidhur me pretendimin se plotësohen kushtet e kërkuara nga shkronja “c”, e nenit 494 të Kodit të Procedurës Civile, për rishikimin e vendimit nr. 13, datë 08.07.2020, të Kolegjit

16. Gjykata Kushtetuese në jurisprudencën⁶ e saj është shprehur se kërkesa për rishikim përfaqëson një formë të veçantë ankimi, një mjet të jashtëzakonshëm, me anë të të cilit kërkohet rishikimi i një vendimi të formës së prerë të gjykatës. Nëpërmjet këtij mjeti ankimi mund të hapet një gjykim i mbyllur në mënyrë përfundimtare nga gjykata. Duke qenë një mjet i jashtëzakonshëm, pasi ka për objekt një vendim gjyqësor të formës së prerë, me autoritetin e gjësë së gjykuar, pala e interesuar mund të kërkojë rishikimin e një vendimi gjyqësor vetëm për një numër të kufizuar shkaqesh, të parashikuara shprehimisht nga dispozitat procedurale përkatëse.

⁴ Shih vendimin e GjEDNj-së *Antoneta Sevdari kundër Shqipërisë*, paragrafi 110.

⁵ Shih vendimin e GjEDNj-së *Xhoxhaj kundër Shqipërisë*, paragrafi 254.

⁶ Shih vendimet nr. 36, datë 26.07.2011 dhe nr. 76, datë 22.12.2015, të Gjykatës Kushtetuese.

17. Në praktikën e konsoliduar të GjEDNj-së është mbajtur qëndrimi se parimi në bazë të të cilit një vendim përfundimtar i formës së prerë është gjë e gjykuar dhe zgjidh mosmarrëveshjen midis palëve me një efekt përfundimtar, është një element themelor i të drejtës për një gjykim të drejtë që garantohet nga neni 6 i Konventës në çështjet civile. Parimi i sigurisë juridike dikton rregullin që kur mosmarrëveshja civile është shqyrtuar në themel nga gjykatat ajo duhet të vendoset njëherë e përgjithmonë dhe nuk duhet të diskutohet apo të vihet në pikëpyetje⁷.
18. Gjithashtu, GjEDNj-ja ka theksuar se parimi i gjësë së gjykuar nënkupton që asnjë palë nuk ka të drejtë të kërkojë rishikimin e një vendimi të formës së prerë vetëm për të përfituar një ridëgjim në seancë gjyqësore, një rishqyrtim dhe një rigjykim të çështjes. Kompetencat për rishikim të gjykatave më të larta duhen ushtruar për korrigjimin e gabimeve gjyqësore dhe dështimeve në dhënien e drejtësisë, jo për të kryer një gjykim të ri të çështjes. Rishikimi nuk duhet trajtuar si një apel i fshehur dhe thjesht mundësia e ekzistencës të pikëpamjeve të ndryshme në lidhje me objektin e gjykimit nuk përbën bazë për rishqyrtim. Anashkalimi i këtij parimi, justifikohet vetëm kur bëhet e nevojshme nga rrethanat me natyrë të rëndësishme dhe detyruese⁸.
19. Bazuar në jurisprudencën e mësipërme, trupi gjykues çmon se rishikimi i vendimit gjyqësor të formës së prerë, duke pasur karakter përjashtimor, mund të bëhet vetëm për shkaqe të parashikuara në mënyrë qartësisht specifike nga ligji procedural dhe jo në çdo rast që kërkohet nga kërkuesi. Në këtë linjë arsyetimi, ekzistenca e shkaqeve të pranueshmërisë duhet t'i nënshtrohet një vlerësimi dhe interpretimi strikt dhe rigoroz të dispozitës ku është bazuar kërkesa.
20. Në rastin konkret, kërkuesja i bazon kërkesat për rishikimin e vendimit nr. 13, datë 08.07.2020, të Kolegjit, në nenin 494, shkronja "c" të Kodit të Procedurës Civile, në të cilin parashikohet se pala e interesuar mund të kërkojë rishikimin e një vendimi që ka marrë formë të prerë, kur: *"Palët ose përfaqësuesit e tyre apo ndonjë anëtar i trupit gjykues që ka marrë pjesë në gjykimin e çështjes, kanë kryer vepra të dënueshme penalisht, të cilat kanë ndikuar në dhënien e vendimit"*. Sipas saj plotësohen në mënyrë kumulative të gjithë kushtet e kërkuara nga shkronja "c", e nenit 494 të Kodit të Procedurës Civile, si dhe dispozitat e tjera vijuese të këtij Kodi për rishikimin e vendimit.
21. Nga përmbajtja e shkronjës "c" të nenit 494, lexuar në harmoni me nenin vijues 495 të Kodit të Procedurës Civile, sipas së cilit *rishikimi i vendimeve për rrethanat e parashikuara në shkronjat "b", "c" dhe "ç" të nenit 494 të këtij Kodi lejohet kur ato rrethana janë vërtetuar me vendim penal të formës së prerë*, rezulton se që kërkesa për rishikim të pranohet nga gjykata duhet të plotësohen kushtet :
- *Palët ose përfaqësuesit e tyre apo ndonjë anëtar i trupit gjykues që ka marrë pjesë në gjykimin e çështjes, kanë kryer vepra të dënueshme penalisht;*
 - *Rrethana/ kryerja e veprës penale të jetë vërtetuar me vendim penal të formës së prerë;*
 - *Vepra penale e kryer ka ndikuar në dhënien e vendimit, i cili kërkohet të rishikohet.*

⁷ Shih çështjen *Kehaya dhe të tjerë kundër Bullgarisë*, app no 477 97/99 dhe 68698/01, datë 12.01.2006.

⁸ Shih çështjen *Brumarescu kundër Rumanisë*, app no 28342/95, datë 28.10.1999.

22. Rezulton e provuar nga vendimet gjyqësore të të tri shkallëve⁹ se ish-gjyqtari L.D. ka kryer një veprë të dënueshme penalisht dhe është dënuar me vendim gjyqësor të formës së prerë, dhe në këtë rast nuk është e nevojshme të bëhet një analizë apo argumentim i mëtejshëm për plotësimin e këtyre kushteve të përcaktuara nga dispozitat e mësipërme.
23. Trupi gjykues vëren se rëndësi në çështjen në fjalë ka analiza nëse në rastin e kërkujes provohet se vepra penale për të cilën është dënuar ish-gjyqtari ka ndikuar drejtpërdrejt, përtej çdo dyshimi, mbi vendimin e dhënë nga Kolegji për kërkuesen. Është pikërisht lidhja shkakësore që duhet të arrihet të provohet në këtë rast, midis veprës penale dhe dënimit të gjyqtarit dhe ndikimit që ky i fundit, duke qenë në kushtet e një personi që ka konsumuar këtë veprë penale, ka ushtruar në dhënien e vendimit ndaj kërkujes.
24. Nga vendimi nr. {***}, datë 01.12.2020, i Gjykatës së Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, rezulton se ish-gjyqtari L.D. është dënuar për veprën penale të “Falsifikimit të dokumenteve”, të parashikuar nga neni 186/1 i Kodit Penal, pasi ish-gjyqtari gjatë aplikimit për në një nga vendet e lira në institucionet e rivlerësimit, në kërkesën e depozituar në Institucionin e Avokatit të Popullit ka pasqyruar të dhëna të rreme. Vepra penale për të cilën është dënuar ish-gjyqtari rezulton të jetë konsumuar me dorëzimin e kërkesës për aplikim të datës 03.02.2017, që është konsideruar nga gjykatat si objekti material i veprës penale. Ish-gjyqtari e ka kryer veprën penale në kohën që ka qenë duke aplikuar për pozicionin e anëtarit të Kolegjit të Posaçëm të Apelit, kur nuk ishte zgjedhur akoma në detyrë, zgjedhje që është bërë më vonë me vendimin e Kuvendit nr. 82, datë 17.06.2017.
25. Nga të dhënat e mësipërme rezulton se vepra e dënueshme penalisht është kryer nga ish-gjyqtari L.D. disa vite para dhënies së vendimit për kërkuesen (në datën 08.07.2020), në kohën kur ai nuk ishte zgjedhur akoma dhe nuk kishte filluar funksionin si gjyqtar i Kolegjit të Posaçëm të Apelit. Pavarësisht se ish-gjyqtari është dënuar më vonë, në kohën kur ka qenë duke ushtruar funksionin, relevant është fakti që vepra e dënueshme penalisht është konsumuar më parë. Në shkronjën “c” të nenit 494 të Kodit të Procedurës Civile flitet për *anëtar të trupit gjykues që ka kryer vepra të dënueshme penalisht*, që nënkupton se ka dy rrethana që duhet të plotësohen, personi duhet të jetë anëtar i trupit gjykues, që nënkupton se është duke ushtruar funksionin si gjyqtar, dhe po si gjyqtar në detyrë duhet të ketë kryer një veprë të dënueshme penalisht. Fakti që në rastin konkret vepra e dënueshme penalisht është kryer nga z. L.D. para marrjes së detyrës si gjyqtar i Kolegjit, dhe disa vite para dhënies së vendimit të Kolegjit që kërkohet të rishikohet, e shkapton këtë lidhje logjike dhe ligjore që kanë dy rrethanat e mësipërme, duke mosplotësuar njëkohësisht *qenien gjyqtar dhe kryerjen e veprës të dënueshme penalisht*. Për rrjedhojë, në rastin konkret, nuk plotësohet lidhja në kohë midis kryerjes së veprës së dënueshme penalisht dhe qenies gjyqtar të z. L.D. në kohën e kryerjes së kësaj vepre penale.
26. Rëndësi në vlerësimin e kushteve për rishikimin e një vendimi ka dhe fakti se sipas dispozitës vepra e dënueshme penalisht, jo vetëm duhet të jetë kryer gjatë periudhës që gjyqtari ka qenë në detyrë, por duhet të provohet dhe që ajo ka lidhje dhe ka ndikuar drejtpërdrejt në vendimin

⁹ Vendimi nr. {***}, datë 01.12.2020, i Gjykatës së Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar; Vendimi nr. {***}, datë 08.03.2021, i Gjykatës së Posaçme të Apelit për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar; Vendimi nr. {***}, datë 21.03.2023, i Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë.

që kërkohet të rishikohet. Në rastin e zbatimit të dispozitës, jo çdo vendim penal ndaj gjyqtarit mund të përbëjë shkak për rishikimin e vendimeve që janë dhënë prej tij. Në rastin e kërkueses, vepra penale për të cilën është dënuar ish-gjyqtari, “Falsifikim i dokumenteve”, për nga lloji i saj nuk rezulton të ketë lidhje dhe të duket se mund të ketë ndikuar në vendimin për kërkuesen në kuadër të procesit të rivlerësimit të saj. Për sa kohë që kërkuesja nuk sjell asnjë argument dhe provë konkrete se kryerja e veprës penale ka qenë e lidhur drejtpërdrejt me prekjën e interesave të saj, nuk shpjegohet se si kjo veprë penale mund të ketë ndikuar dhe të ketë qenë shkak determinant në vendimin e dhënë ndaj saj.

27. Në kërkesat e saj kërkuesja shprehet dhe se ish-gjyqtari L.D., si relator i çështjes së saj, ka shtrembëruar faktet dhe provat e paraqitura në procesin e rivlerësimit të kërkueses, por pa paraqitur asnjë argumentim apo indicie për ekzistencën e elementit subjektiv, qëllimit, motivimit apo keqdashjes së ish-gjyqtarit për të shtrembëruar faktet dhe për të dhënë një vendim të padrejtë në dëm të saj. Edhe në këtë rast, trupi gjykues vëren se kërkuesja nuk arrin të provojë asnjë lidhje midis veprës penale për të cilën është dënuar ish-gjyqtari L.D. dhe pretendimeve të saj.
28. Gjithashtu, trupi gjykues vëren se kërkuesja nuk arrin të argumentojë dhe të sjellë në kërkesat e saj asnjë element që do të provonte dhe pretendimin për ndikim të veprës penale/dënimit penal të gjyqtarit direkt në vendimmarrjen e trupit gjykues për rastin e saj. Sipas kërkueses, fakti që ish-gjyqtari L.D. ka qenë relator i çështjes ka qenë vendimtar në dhënien e vendimit ndaj saj. Lidhur me sa parashtron kërkuesja, konstatohet se, pavarësisht se ish-gjyqtari ka qenë relator i çështjes, nuk provohet se ai mund të ketë ndikuar anëtarët e tjerë të trupit gjykues, pasi secili anëtar i trupit gjykues voton sipas bindjes së brendshme të tij. Ish-gjyqtari L.D., si një nga anëtarët e trupit gjykues, ka pasur vetëm një votë në dhënien e vendimit unanimit për lënien në fuqi të vendimit të shkarkimit të kërkueses nga Komisioni. Për më tepër, trupi gjykues vëren se kërkuesja nuk tenton as të argumentojë se në mungesë të kryerjes së veprës penale ish-gjyqtari do të kishte relatuar ndryshe çështjen e saj apo trupi gjykues do të kishte dhënë një vendim të ndryshëm.
29. Sa paraqitur më sipër, në konkluzion, trupi gjykues çmon se nuk ka asnjë lidhje shkakësore si në kohë ashtu dhe në veprime të qëllimshme, midis kryerjes së veprës penale nga ish-gjyqtari L.D. dhe vendimit të dhënë për kërkuesen në procesin e rivlerësimit të saj. Kërkuesja ka dështuar të provojë pasojën e drejtpërdrejtë të veprës penale në cenimin e interesave të saj dhe dhënien e një vendimi jo pozitiv ndaj çështjes së saj. Në këto kushte, në mungesë të provueshmërisë se kryerja e veprës penale nga ana e ish-gjyqtarit L.D. ka ndikuar në dhënien e vendimit objekt kërkese, arrihet në përfundimin se, në ndryshim nga sa pretendon kërkuesja, nuk plotësohen në mënyrë kumulative kushtet, sipas shkronjës “c”, të nenit 494 të Kodit të Procedurës Civile dhe, për këtë arsye, janë të pabazuara kërkesat e saj për rishikimin e vendimit nr. 13, datë 08.07.2020, të Kolegjit.
30. Për sa u përket pretendimeve të tjera të kërkueses për zhvillimin e procesit të rivlerësimit kalimtar ndaj saj në Kolegj, lidhur me shqyrtimin e çështjes në seancë publike apo analizën e provave, vlerësohet se këto pretendime janë jashtë objektit të vlerësimit të kushteve për rishikimin e një vendimi, sipas dispozitave të Kodit të Procedurës Civile.

31. Në përfundim, pas shqyrtimit të të dy kërkesave, trupi gjykues i Kolegjit vlerësoi se asnjë prej tyre nuk bazohet në nenin 494, shkronja “c” të Kodit të Procedurës Civile, për arsye se vepra penale për të cilën është dënuar anëtari i trupit gjykues L.D. është kryer para se ai të fillonte ushtrimin e detyrës së gjyqtarit të Kolegjit të Posaçëm të Apelit dhe nuk ka ndikuar në dhënien e vendimit për të cilin është kërkuar rishikimi.

PËR KËTO ARSYE,

Kolegji, bazuar në nenin 498, pika 1 të Kodit të Procedurës Civile,

V E N D O S I:

Mospranimin e kërkesave të kërkuases Ana Golloshi, për rishikimin e vendimit nr. 13, datë 08.07.2020, të Kolegjit të Posaçëm të Apelit, të regjistruara me nr. 6-18/2019 (JR), datë 15.02.2022 dhe nr. 67/7prot., datë 22.01.2024.

U shpall sot, në Tiranë, më datë 15.02.2024.

ANËTARE

Albana SHTYLLA

nënshkrimi

ANËTAR

Sokol ÇOMO

nënshkrimi

ANËTARE

Rezarta SCHUETZ

nënshkrimi

RELATORE

Mimoza TASI

nënshkrimi

KRYESUESE

Ina RAMA

nënshkrimi

MENDIM PARALEL

1. Unë, gjyqtare Mimoza Tasi, në cilësinë e relatores, jam dakord me vendimin nr. 4, datë 15.2.2024, të Kolegjit të Posaçëm të Apelimit (në vijim “Kolegji”), që i përket shqyrtimit të dy kërkesave të kërkuases Ana Gollosi për rishikimin e vendimit gjyqësor të formës së prerë nr. 13, datë 08.07.2020, të Kolegjit të Posaçëm të Apelimit, por kam ndarë mendim ndryshe me shumicën e trupit gjykues, për sa i përket konkluzionit të arritur për mospranimin e kërkesës.
2. Në vlerësimin tim, të dyja kërkesat e paraqitura nga kërkuësja Ana Gollosi, nuk plotësojnë kërkesat formale për t’iu nënshtruar shqyrtimit në Kolegj, për shkak se kërkesa e parë është pa objekt, pasi është ngritur mbi një vendim të shfuqizuar nga Gjykata Kushtetuese¹⁰ në momentin e shqyrtimit të saj dhe kërkesa e dytë është depozituar në Kolegj në tejkalim të afatit ligjor të përcaktuar në nenin 496¹¹ të Kodit të Procedurës Civile, referuar datës së vendimit penal të Gjykatës së Lartë¹². Qëndrimin tim për vlerësimin e mësipërm, e kam bazuar në argumentet në vijim.
3. Vendimi i arsyetuar nga shumica e trupit gjykues nuk përmban një element të rëndësishëm të tij, që është legjitimimi në kohë *ratione temporis* i kërkuases, në bazë të së cilës bëhet verifikimi nëse kërkesa është paraqitur brenda afateve ligjore të përcaktuara në nenet respektive të Kodit të Procedurës Civile, (në vijim “Kodi”). Anashkalimi nga shumica i verifikimit të këtij elementi që ka të bëjë me afate ligjore të përcaktuara qartë, në rastin e kërkesave për rishikim, që janë një mjet i jashtëzakonshëm ankimi, në vlerësimin tim, mund të çojë në cenimin e parimit të sigurisë juridike.

a. Për kërkesën e parë

4. Kërkuësja ka paraqitur kërkesën për rishikimin e vendimit nr. 13/2020 të Kolegjit të Posaçëm të Apelimit. Kërkesa është regjistruar në Kolegj me nr. 6-18/2019 (JR), datë regjistrimi 15.02.2022. Kërkuësja e bazon kërkesën e parë të saj për rishikimin e vendimit nr. 13/2020 të Kolegjit, në: (i) vendimin nr. {***}, datë 01.12.2020, të Gjykatës së Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar; (ii) vendimin nr. {***}, datë 08.03.2021, të Gjykatës së Posaçme të Apelit për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar; (iii) vendimin nr. {***}, datë 26.10.2021, të Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë; dhe (iv) vendimin nr. {***}, datë 09.12.2021, të Komisionit Disiplinor të Kolegjit të Posaçëm të Apelimit.
5. Lidhur me anën formale të plotësimit të parashikimeve të nenit 497¹³, pikat 1 dhe 2 të Kodit të Procedurës Civile, për elementet që duhet të përmbajë kërkesa për rishikim në momentin e

¹⁰ Vendimi i Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë nr. 21, datë 26.09.2022, ka vendosur: “(i) Pranimin pjesërisht të kërkesës. (ii) Shfuqizimin e vendimit nr. {***}, datë 26.10.2021, të Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë, si të papajtueshëm me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë. (iii) Dërgimin e çështjes për rigjykim në Gjykatën e Lartë”.

¹¹ Neni 496 parashikon se: “Kërkesa për rishikim mund të paraqitet brenda 30 ditëve nga dita që pala provon se ka marrë dënimin për shkakun e rishikimit. Në rastet e parashikuara në nenin 495, afati prej 30 ditësh fillon nga dita që vendimi ka marrë formën e prerë”.

¹² Vendimi nr. {***}, datë 21.03.2023, i Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë.

¹³ Neni 497, “Paraqitja e kërkesës”: “1. Kërkesa për rishikim paraqitet para gjykatës së shkallës së parë që ka dhënë vendimin, por në rast se vendimi është ankimuar në gjykatat më të larta, kompetente është gjykata më e lartë që ka shqyrtuar çështjen në themel. Gjykata kompetente për shqyrtimin e kërkesës për rishikim, gjykon sipas

paraqitjes së saj, nga Kolegji është konstatuar se plotësohen kushtet sipas pikës 1 të këtij neni, pasi kërkesa është paraqitur pranë Kolegjit, si gjykata më e lartë që ka shqyrtuar çështjen në themel, si dhe përmban shkaqet dhe provat mbi të cilat kërkohet rishikimi.

6. Kërkuesja e ka bazuar kërkesën e parë për rishikim (por edhe kërkesën e dytë), në nenin 494, shkronja “c” e Kodit, sipas të cilit: *Palët ose përfaqësuesit e tyre apo ndonjë anëtar i trupit gjykues që ka marrë pjesë në gjykimin e çështjes, kanë kryer vepra të dënueshme penalisht, të cilat kanë ndikuar në dhënien e vendimit.* Neni 495 i këtij Kodi përcakton se: *Rishikimi i vendimeve për rrethanat e parashikuara në shkronjat “b”, “c” dhe “ç” të nenit 494 të këtij Kodi, lejohet kur ato rrethana janë vërtetuar me vendim penal të formës së prerë.* Nga interpretimi i këtyre dy dispozitave procedurale në lidhje me njëra-tjetrën, rezulton e qartë se një nga kushtet për të pranuar që ekzistojnë shkaqe për rishikimin e një vendimi, është që vepra e dënueshme penalisht të jetë vërtetuar me një vendim penal të formës së prerë.
7. Rezulton i provuar nga burime të hapura se vendimi nr. {***}, datë 26.10.2021, i Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë (mbi bazën e të cilit është paraqitur kërkesa për rishikim), i cili kishte vendosur lënien në fuqi të vendimit të Gjykatës së Posaçme të Apelit nr. {***}, datë 08.03.2021, është shfuqizuar me vendimin nr. 21, datë 26.09.2022, të Gjykatës Kushtetuese, që ka vendosur shfuqizimin e tij si të papajtueshëm me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë, duke e dërguar çështjen për rigjykim në Gjykatën e Lartë.
8. Referuar vendimmarrjes unifikuese që Kolegjet e Bashkuara të Gjykatës së Lartë, i kanë bërë kuptimit që duhet të ketë “vendimi i formës së prerë”, për efekt të gjësë së gjykuar¹⁴, i tillë konsiderohet vendimi nr. {***}, datë 26.10.2021, i Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë. Me shfuqizimin nga Gjykata Kushtetuese të këtij vendimi të Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë, dënimi penal i ish-gjyqtarit L. D. nuk ka marrë formë të prerë në kuptim të “gjësë së gjykuar”, për sa kohë Gjykata Kushtetuese kishte disponuar për rigjykimin e çështjes në Gjykatën e Lartë.
9. Pavarësisht se në momentin e paraqitjes së kërkesës nga kërkuesja, më datë 12.02.2022, vendimi nr. {***}, datë 26.10.2021, i Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë ka qenë në fuqi, vlerësimi dhe interpretimi i bazueshmërisë ligjore të kërkesës bëhet sipas situatës ligjore në momentin e shqyrtimit të kërkesës në Kolegj. Për më tepër, rezulton se më datë 17.01.2022, ish-gjyqtari L. D. kishte depozituar në Gjykatën Kushtetuese kërkesën për shfuqizimin e vendimeve gjyqësore të të tria shkallëve dhe, pavarësisht se kërkesa e kërkueses nuk lidhet me datën e depozitimit të kërkesës së ish-gjyqtarit, nga ana e saj si person i interesuar drejtpërdrejt, duhej të tregohej kujdes dhe të konsiderohej prej saj momenti i paraqitjes për efekt të lindjes

rregullave të zbatueshme për atë shkallë gjykimi. Kërkesa duhet të përmbajë: shkakun për të cilin kërkohet rishikimi, provat përkatëse që lidhen me një nga kërkesat e nenit 49 të këtij Kodi, ditën e zbulimit ose të vërtetimit të rrethanës ose marrjes së dokumenteve. 2. Kërkesa nënshkruhet nga avokati i pajisur me prokurë dhe nëse pala e kërkon, edhe nga kjo e fundit. 3. Kërkesa e paraqitur pa u plotësuar ose në kundërshtim me kriteret e mësipërme, kthehet për plotësim nga gjykata. Në rast se kërkesa nuk plotësohet brenda një afati 10-ditor, gjykata vendos mospranimin e saj”.

¹⁴ Kolegjet e Bashkuara të Gjykatës së Lartë, në Vendimin Unifikues nr. 2, datë 03.11.2014, në trajtimin e çështjes se: “Në mungesë të një përkufizimi juridik të parashikuar nga Kodi i Procedurës Penale, ç’do të kuptojmë me shprehjen “vendim i formës së prerë?”, dhe se si duhet të konsiderohen nocionet “vendim i ekzekutueshëm”, “vendim i formës së prerë” dhe “gjë e gjykuar”, kanë mbajtur qëndrimin: “26. Kolegjet e Bashkuara të Gjykatës së Lartë vlerësojnë se duhet rikonfirmuar pohimi sipas të cilit rekursi në Gjykatën e Lartë përbën mjet të zakonshëm ankimi, shterimi i të cilit e kthen vendimin në formë të prerë në kuptimin e “gjësë së gjykuar [...]”.

së mundësisë që vendimi i Gjykatës së Lartë mund të pësonte ndryshim/shfuqizim (sikurse provohet me vendimin e Gjykatës Kushtetuese).

10. Kërkesa e paraqitur nga kërkuesja, e bazuar në një vendim të shfuqizuar/jo të formës së prerë, vlerësoj se nuk përmbush kushtet e pranueshmërisë nga ana formale sipas parashikimeve të nenit 495 të Kodit, duke u ndodhur në kushtet e mungesës së lëndës/objektit mbi të cilën është ngritur kjo kërkesë.
11. Në konkluzion për kërkesën e parë, vlerësoj se Kolegji, bazuar në nenin 498, pika 1¹⁵ e Kodit të Procedurës Civile, duhet të mos e pranonte kërkesën e kërkueses Ana Gollosi për rishikimin e vendimit nr. 13, datë 08.07.2020, të Kolegjit, pasi nuk përmban shkaqe nga ato që parashikon neni 494 i Kodit të Procedurës Civile.

b. Për kërkesën e dytë

12. Në datën 22.01.2024, kërkuesja ka paraqitur një kërkesë tjetër me të njëjtin objekt, e cila është regjistruar në Kolegj me nr. {***}, datë 22.01.2024. Në dallim nga kërkesa e parë e datës 15.02.2022, kërkesën e dytë kërkuesja e ka bazuar jo më në vendimin nr. {***}, datë 26.10.2021, të Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë, i shfuqizuar nga Gjykata Kushtetuese, por në vendimin nr. {***}, datë 21.03.2023, të Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë.
13. Për sa i përket afatit të paraqitjes së kërkesës për rishikim, sipas parashikimeve të nenit 496 të Kodit të Procedurës Civile: *Kërkesa për rishikim mund të paraqitet brenda 30 ditëve nga dita që pala provon se ka marrë dijëni për shkakun e rishikimit. Në rastet e parashikuara në nenin 495, afati prej 30 ditësh fillon nga dita që vendimi ka marrë formën e prerë.* Kjo dispozitë, në fjalinë e dytë referon në rastet e parashikuara nga neni 495, të cilat kanë lidhje të drejtpërdrejtë me rrethanat e parashikuara në shkronjat “b”, “c” dhe “ç” të nenit 494 të këtij Kodi, të cilat janë:
b) vërtetohet se thënie e dëshmitarëve apo mendimet e ekspertëve, mbi të cilat është bazuar vendimi, kanë qenë të rreme; c) palët ose përfaqësuesit e tyre apo ndonjë anëtar i trupit gjykues, që ka marrë pjesë në gjykimin e çështjes, kanë kryer vepra të dënueshme penalisht, të cilat kanë ndikuar në dhënien e vendimit; ç) vërtetohet se vendimi i dhënë është bazuar në dokumente të falsifikuara. Sipas parashikimit të nenit 496, në rastin e vendimeve të dhëna për rrethanat e mësipërme, afati për paraqitjen e kërkesës është afati prekluziv 30-ditor, i cili e kushtëzon qartësisht paraqitjen e kërkesës jo me momentin e marrjes dijëni, por me momentin kur këto rrethana janë vërtetuar me vendim penal të formës së prerë. Pra, lindja e së drejtës për paraqitjen e kërkesës për rishikim lidhet vetëm me afatin e marrjes fuqi të vendimit penal të formës së prerë.
14. Kërkuesja në kërkesë pretendon se është vënë në dijëni nëpërmjet mediave se Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë ka lënë në fuqi vendimin e Gjykatës së Posaçme për dënimin e ish-gjyqtarit dhe, për këtë arsye, i është drejtuar kësaj gjykate në datën 17.01.2024 me kërkesë (rreth dhjetë muaj pas shpalljes së tij), për t'i vënë në dispozicion një kopje të vendimit, për ta depozituar në Kolegj si provë për shoqërimin e kërkesës së dytë të saj.

¹⁵ Neni 498: “Shqyrtimi i kërkesës”, pika 1: “Kur kërkesa është bërë jashtë rasteve të përcaktuara në nenin 494 ose kur është bërë nga ata që nuk e kanë këtë të drejtë, si dhe kur rezulton haptazi e pambështetur, gjykata vendos mospranimin e saj”.

15. Konstatohet se kërkesja e lidh dhe e legjitimon afatin e dorëzimit të kërkesës së dytë për rishikim me afatin 30-ditor nga dita që pala provon se ka marrë dëgjimin për shkakun e rishikimit, referuar fjalisë së parë të nenit 496 të Kodit, dhe duke konsideruar si datë njoftimi datën 19.01.2024, kur ka marrë shkresën dhe kopjen e vendimit nga Gjykata e Lartë. Ndërkohë, ashtu si është trajtuar më lart, në rastet e vendimeve të formës së prerë që janë të lidhura me rrethanat e parashikuara në shkronjat “b”, “c” dhe “ç” të nenit 494 të Kodit, sipas fjalisë së dytë të nenit 496 të tij, afati 30-ditor për paraqitjen e kërkesës për rishikim fillon nga dita kur vendimi lidhur me këto rrethana, ka marrë formë të prerë. Për këto arsye, në rastin e kërkesës e cila e ka bazuar kërkesën e saj në shkronjën “c” të nenit 494 të Kodit, çmoj se afati për rishikimin ka filluar me shpalljen e vendimit nr. {***}, datë 21.03.2023, të Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë, dhe kërkesja duhet ta ushtronte të drejtën e kërkesës për rishikim brenda 30 ditësh nga shpallja e këtij vendimi, me të cilin ka marrë formë të prerë vendimi penal.
16. Për sa më lart, rezultojnë e provuar se kërkesa e dytë e kërkesës Ana Golloshi për rishikimin e vendimit nr. 13, datë 08.07.2020, të Kolegjit, në kuptim të verifikimit të kërkesave formale që kanë të bëjnë me paraqitjen tej afatit 30-ditor të përcaktuar nga neni 496 i Kodit të Procedurës Civile dhe, në vlerësimin tim, shumica e trupës gjyqësore duhet të vendoste mospranimin e kërkesës për këtë shkak dhe jo të shqyrtonte ekzistencën e shkaqeve të rishikimit, sipas shkronjës “c” të nenit 494 të Kodit, duke pranuar shkeljen e afatit kohor nga kërkesja.
17. Në përfundim të këtij arsyetimi, konkludohet se të dyja kërkesat e kërkesës Ana Golloshi për rishikimin e vendimit nr. 12/2019 të Kolegjit, sipas shkronjës “c” të nenit 494 të Kodit të Procedurës Civile, nuk duhet t’i nënshtroheshin shqyrtimit në Kolegj për shkaqet e pranueshmërisë në kushtet kur ato nuk plotësonin kërkesat formale që lidhen me ekzistencën e objektit të gjykimit, si dhe me tejkalimin e afateve prekluzive ligjore.

GJYQTARE

Mimoza TASI

nënshkrimi